



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut
Skupstina Opstine
Municipal Istog

Drejtoria Komunale e Arsimit

05.Nr.263/2024
Dt.29.03.2024

Drejtori Komunal i Arsimit në Istog duke u bazuar në nenin 53 dhe 56 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative të Republikës së Kosovës dhe vendimit të komisionit për shqyrtim të ankesave Nr.259/24 dt 27.03.2024, **merr këtë:**

V E N D I M PËR ANULIM TË KONKURSIT

I.Anulohet konkursi 05.Nr.83/24 i shpallur me datën: 06.02.2024 për pozitën Asistent/e për fëmijët/nxënësit me nevoja të veçanta arsimore në IP “Ardhmëria Jonë” në Gurrakoc

II.Shfuqizohet vendimi Nr.241/24 i datës 14.03.2024 i Drejtorisë Komunale të Arsimit në Istog për përzgjedhjen e kandidates Elmaze Gashi.

III.Ky vendimi hynë në fuqi nga data e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Drejtori Komunal i Arsimit në Istog duke u bazuar në vendimin Nr.259/24 dt.27.03.2024 të komisionit për shqyrtim të ankesave dhe parashtresave bënë anulimin e konkursit me numër të protokollit 05.Nr.83/24 të datës 06.02.2024 për Asistent/e për fëmijët/nxënësit me nevoja të veçanta arsimore në IP “Ardhmëria Jonë” në Gurrakoc.

Në vendimin e komisionit për shqyrtim të ankesave dhe parashtresave është thënë se komisioni për zhvillim të procedurave të përzgjedhjes ka vepruar në kundërshtim me nenin 6 pika 5.1 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik kur ka vendosur që të mos propozoj anulimin e konkursit që e kishte obligim ligjor për faktin se asnjëri prej kandidatev/e në procedurë nuk i kishte plotësuar kriteret e konkursit publik respektivisht **kushtet e kualifikimit** mirëpo duke mos propozuar anulimin e konkursit i njëjti ka vazhduar me procedura të rekrutimit duke nxjerrë edhe rezultatet përfundimtare rezultat ky që bie ndesh drejtpërdrejt me dispozitat e Udhëzimit Administrativ të lartcekura.

Andaj nga shkeljet e gjetura nga ana e komisionit për shqyrtim të ankesave ka bërë që kjo procedurë e rekrutimit të anulohet.



Drejtori i DKA-së
Naim Behlulaj